



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS/ VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA**

**PROCESVERBAL**

**Mbledhja e Shtatë e  
Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës**

**Prishtinë, 19 dhjetor 2016  
Ndërtesa e Qeverisë, P-38**

**Morën pjesë:**

**i. Anëtarët e KKZHE-së**

- Isa Mustafa, Kryeministër
- Hykmete Bajrami, ministre e MTI-së – koordinatorë e KKZHE-së
- Avdullah Hoti, ministër i Financave
- Blerand Stavileci, ministër i Zhvillimit Ekonomik
- Florian Dushi, zv. ministër i Drejtësisë
- Valon Murati, ministër i Diasporës
- Memli Krasniqi, ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
- Mendim Rugova, zv. ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
- Usmen Baldzi, MASHT
- Hasan Hasani, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
- Agim Shahini, kryetar i Aleancës Kosovare të Biznesit
- Fadil Hoxha, Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare
- Visar Hapciu, Oda Ekonomike Amerikane
- Iliriana Gashi – Forumi Ekonomik i Grave

## ii. Pjesëmarrës/të ftuar të tjerë

Ramiz Kelmendi - Zv. Kryeministër i Republikës së Kosovës; Muhamet Mustafa - deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës; Sokol Havolli - Shef i Kabinetit, ZKM; Fahri Gashi - Dogana e Kosovës; Sakip Imeri - Drejtor i Përgjithshëm i ATK-së; Petrit Pepaj - ZRRE; Besian Mustafa MTI/KIESA; Valentin Toçi - ZKM; Qemajl Marmullakaj - ZKM/ZPS; Rudina Hera Puka - KEDS/KESCO; Astrit Panxha - Klubi i Prodhuesve të Kosovës; Agron Maxhuni - U.d Sekretar i Përgjithshëm, MTI; Gazmend Mejzini - Kryeshef i ARBK, MTI; Lulzim Krasniqi - Këshilltar Politik dhe Shef i Kabinetit, MTI; Ardiana Meholli - Ambasada Amerikane; Hajdar Korbi - projekti 'Partneritet për Zhvillim' (USAID); Dardane Peja - USAID; Terence Slywka - projekti 'Partneritet për Zhvillim' (USAID); Kreshnik Kurtishi - projekti 'Partneritet për Zhvillim' (USAID); Mentore Elezaj - Këshilltare Politike e ministres, MTI; Besim Zeqiri, IFC.

## RENDI I DITËS

1. Hapja e takimit - Ministrja e Tregtisë dhe Industrisë;
2. Fjala e Kryeministrit Mustafa;
3. Miratimi i Rendit të ditës dhe Procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të KKZHE-së - Ministrja e MTI-së;
4. Efektet e reformave fiskale të ndërmarra nga Ministria e Financave dhe planifikimi për reformat e ardhshme - Ministria e Financave;
5. Prezantimi i Masave të reformës strukturore të Programit për Reforma në Ekonomi (PRE) - Zyra për Planifikim Strategjik (ZKM);
6. Ndryshimi i Ligjit të Punës - Oda Ekonomike Amerikane;
7. Maksigrafi: Përdorimi në Kosovë dhe krahasim me rajonin - OEA;
8. Shqyrtimi i Tarifave Progressive të Energjisë Elektrike nga ZRRE-ja -AKB;
9. Përmbushja e detyrave nga mbledhja e Gjashtë e KKZHE-së - Sekretariati i KKZHE-së;
10. Raportimi për punën e GP-se të KKZHE-së - Kryesuesit e GP-se;
11. Mbyllja e takimit, caktimi i datës për mbledhjen e ardhshme të KKZHE-së (Ministrja e MTI-së).

## 1. Hapja e takimit

**Ministrja Bajrami:** Më lejoni t'ju uroj mirëseardhje në takimin e shtatë me radhë dhe të fundit për vitin 2016 të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës. KKZHE, i cili kryesohet nga Kryeministri i Republikës së Kosovës, është shndërruar në një mekanizëm funksional të dialogut publik-privat i cili po punon në përmirësimin e mjedisit afarist në vend që është njëri nga top prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Gjatë këtij viti janë shënuar një varg zhvillimesh pozitive lidhur me avancimin e agjendës sonë ekonomike, dhe me këtë rast, dua të falënderoj Kryeministrin e vendit për lidhësinë e tij, kolegët nga KKZHE për angazhimin e tyre, si dhe asociacionet e biznesit të cilët kanë qenë mjaft aktive, bashkëpunuese dhe konstruktive duke kontribuar në thellimin e dialogut me institucionet qeveritare në funksion të lehtësimit të punës së bizneseve dhe krijimit të politikave në favor të biznesve nga vendi dhe tërheqjes së investitorëve nga jashtë. Tani kam kënaqësinë të ftoj z. Kryeministër Mustafa për të hapur punimet e këtij takimi si dhe për të na folur më shumë lidhur me zhvillimet dhe arritjet ekonomike të Republikës së Kosovës gjatë kësaj periudhe.

## 2. Fjala e Kryeministrit Mustafa

**Kryeministri Mustafa:** Më lejoni që të hap punimet e mbledhjes së shtatë të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik. Shfrytëzoj rastin t'ju falënderoj të gjithë juve për iniciativat që në të kaluarën keni dhënë, në mënyrë që të sigurojmë një punë të angazhuar dhe shumë konkrete të KKZHE-së. Ky Këshill, por edhe format e tjera të angazhimit tonë, kanë kontribuar që ne të mbajmë zhvillimin ekonomik si prioritet tonin dhe poashtu të tregojmë rezultate të caktuara, të cilat karshi ambientit në të cilin ne jemi, janë mjaft të mira dhe inkurajuese edhe në të ardhmen. Me këtë kemi arritur që prioritetin e zhvillimit ekonomik ta kemi si çështje të parë, edhe përkundër një ambienti politik në të cilin kemi vepruar, e që s'ka qenë shumë i përshtatshëm për këtë. Më lejoni t'ju uroj mirëseardhje Forumit Ekonomik të Grave në këtë Këshill, i cili forum për herë të parë po merr pjesë në këtë KKZHE dhe do të jetë anëtare e tij. Qëllimi është që ne të fuqizojmë rolin e grave në zhvillimin ekonomik, të sigurojmë pjesëmarrjen e tyre në ndërtimin e politikave ekonomike dhe në interpretimin dhe korrigjimin e ambientit politik, në të cilin ne tani ndodhemi. Konsideroj që ne kemi arritur të krijojmë një ambient të favorshëm për të bërë biznes, qoftë përmes politikave fiskale, të cilat i kemi ndërtuar deri më tani dhe të cilat janë në favor të prodhimeve vendore në krahasim me ato që i kemi pasur më parë, qoftë edhe si interaksion yni në politikat e përgjithshme ekonomike në regjion. Nga takimi që ne kemi pasur herën e kaluar në KKZHE, unë dëshiroj të ndalem në disa procese aktuale. Ndërkohë kemi mbajtur takimin e parë të Këshillit të Stabilizim-Asociimit në Bruksel dhe kemi nënshkruar një marrëveshje kornizë me Bashkimin Evropian, e cila i jep qasje Kosovës në programet e BE-së, disa prej të cilave janë të rëndësishme për bizneset kosovare, si është "Cosme", "Horizon", etj., e të cilat iu ofrojnë ndihma financiare të drejtpërdrejta ndërmarrjeve. Ky nënshkrim do të ndikojë që ne të kemi qasje më të shpejtë në këto fonde. Pastaj, kemi pasur një përmirësim të Kosovës në raportin e Bankës Botërore për të bërë biznes. Kosova është renditur në vendin e 60-të nga ai 66-të që ka qenë më parë, ndërsa progreset e veçanta kemi treguar në indikatorët që kanë të bëjnë me 'fillimin e biznesit' në 'tregtinë përtej kufijve' dhe me 'pagesat e tatimeve' që janë tri fusha shumë të rëndësishme për ne. Kemi biseduar ndërkohë në suaza të Task Forcës, që ne të punojmë edhe në fushat e tjera, në mënyrë që të sigurojmë përmirësimin edhe në të ardhmen dhe ky përmirësim do të shprehet pozitivisht edhe sa i përket investitorëve të jashtëm, por edhe sa i përket ambientit të

përgjithshëm të biznesit. Kemi punuar për përmirësimin e legjislacionit, në eliminimin e burokracisë. Janë bërë dhe po bëhen investime në infrastrukturën fizike. Pastaj ka filluar implementimi i lehtësisë në qasjen në financa dhe në këtë rast vlen të përmendet që përmes fondit për garantimin e kredive deri më tani janë lëshuar 63 kredi për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që është një nxitje e veçantë. Në anën tjetër, përmes Bankës Evropiane për Zhvillim dhe Ndërtim dhe me ndihmën e donatorëve të tjerë, po implementojmë projektin për certifikimin e produkteve kosovare, që do të ndikojë pozitivisht në hapjen e rrugëve për eksport. MTI ka financuar pjesëmarrjen e 190 ndërmarrjeve në 17 panairë të ndryshme, janë ekspozuar shumë produkte të tyre, janë lidhur disa kontrata të rëndësishme. Po punohet tani me BE-në në agjendën e reformave evropiane, që ka të bëjë kryesisht me rritjen e konkurrueshmërisë së vendit, në rritjen e cilësisë në arsim dhe në rritjen e punësimit përmes harmonizimit të arsimit me politikën e tregut të punës. Si rezultat i kësaj kemi rritje të bizneseve të huaja në Kosovë dhe poashtu kemi rritje të numrit të bizneseve të grave, që është poashtu një cilësi e veçantë. Për vitin e ardhshëm janë një numër i projekteve që ne planifikojmë t'i mbështesim qoftë me donacione, qoftë me forma të tjera, sidomos në fushën e bujqësisë, në të cilën është bërë një arritur shumë e madhe deri më tani, sepse kemi arritur që gati t'i plotësojmë kërkesat e tregut të brendshëm me drithëra që prodhohen në Kosovë. Është arritur që të prodhohen produkte bujqësore të cilat janë konkurruese me vendet e tjera, dhe unë falënderoj në këtë rast, veçmas, përkrahjen e USAID-it tek produktet e reja, me të cilat ne kemi arritur të depërtojmë në tregun e jashtëm dhe të krijojmë një kulturë të re të kultivimit të këtyre produkteve, si dhe Ministrin e Bujqësisë, i cili është këtu me ne. Në mbledhjen e fundit të Qeverisë jemi pajtuar që në parim të fillojmë konsultat me bizneset, me asociacionet e tyre për fazën e dytë të reformës fiskale dhe kjo ka filluar tanimë. Është kyçur edhe zv. kryeministri në këtë fushë dhe unë mendoj që me këtë edhe më tutje të arrijmë të përshtatim politikën fiskale me nevojat e bizneseve dhe ajo që është me rëndësi themelore, të krijojmë kushte të barabarta të konkurrencës ndërmjet bizneseve tona brenda tregut dhe konkurrencës së tyre me bizneset e jashtme. Pa marrë parasysh situatën në të cilën kemi vepruar, kemi arritur rritje ekonomike prej 4.1 për qind në vitin 2015. Presim që kjo rritje në vitin 2016 të jetë më e lartë. Do të kemi poashtu investime të huaja direkte, të cilat janë të rëndësishme, trendi i të cilave ka filluar të rritet vitin e kaluar. Kemi një trend të mirë të uljes së papunësisë edhe në vitin 2015 në krahasim me vitin 2014, edhe në vitin 2016 në krahasim me vitin 2015, gjë që flet se sektori privat po e bënë punën e vet dhe po ndërron mentalitetin e vet dhe të punësuar nuk konsiderohen vetëm ata që janë në sektorin publik, por që ne jemi përcaktuar për ekonominë e tregut dhe problemin e punësimit mund ta zgjidhim vetëm përmes zhvillimit në këtë fushë. Kemi biseduar me ministrat përkatës që të punojmë në reformën ekonomike dhe që programin e saj t'ia dorëzojmë Komisionit Evropian në fillim të vitit të ardhshëm. I kemi harmonizuar gati tërësisht masat të cilat duhet t'i marrim, një pjesë e të cilave mund të diskutohen edhe sot së bashku me ju, por ne jemi të interesuar gjithsesi që çdo gjë që e bëjmë në fushën e zhvillimit ekonomik, të gjitha masat bashkërisht t'i harmonizojmë dhe ato të jenë rezultat i pajtimit dhe vlerësimeve tona të përbashkëta.

### **3. Miratimi i Rendit të ditës dhe Procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të KKZHE-së**

#### **3.1. Kuorumi**

**Ministrja Bajrami:** Sipas rregullores së KKZHE-së, meqë pjesa dërmuese e anëtarëve të Këshillit janë prezent, e kemi korumin dhe mund të kalojmë në pikën tjetër.

### 3.2. Rendi i ditës

KKZHE aprovoi rendin e ditës.

### 3.3. Procesverbali

KKZHE aprovoi procesverbalin e mbledhjes së gjashtë.

**Ministrja Bajrami:** Para se të kalojmë në pikat konkrete të propozuara në rendin e ditës, ju bëj thirrje të gjithë anëtarëve të KKZHE-së dhe katër Task Forcave që janë në kuadër të ministrive për përmirësimin e ambientit të biznesit që të bëjnë përpjekje maksimale për përmirësimin e indikatorëve. Më lejoni t'ju informoj se për përmirësimin e indikatorëve sipas raportit të BB, kemi në dispozicion ndihmën e pakursyer të projektit të USAID-it 'Partneritet për Zhvillim.' Jemi pajtuar dhe kemi mbajtur takimin për ciklin e dytë të reformave dhe në fakt për të gjitha reformat duhet t'i dorëzojnë të gjitha planet për reformat afatshkurtëra duhet t'i dorëzojnë deri me datën 24 dhjetor 2016. I inkurajoj udhëheqësit e task forcave që të bëjnë përpjekje që t'i përmbahemi afateve me të cilat jemi pajtuar në mbledhjen e parë për ciklin e dytë të reformave. Siç e tha Kryeministri, kemi pasur përmirësim në tre indikatorë, mirëpo kjo nuk është e mjaftueshme. Ne dëshirojmë të kemi përmirësime në të gjithë indikatorët. Tanimë raporti i BB e rendit Kosovën në krahasim me vendet fqinje dhe ne duhet të jemi konkurent, në mënyrë që të përmirësojmë indikatorët. Më lejoni t'ju njoftoj që vitin tjetër kur fillojmë me sigurimet shëndetësore ka shumë gjasa që në qoftë se nuk bëjmë progres në indikatorët të tjerë, atëherë të pësojmë regres sa i përket raportit të BB për të bërit biznes. Edhe njëherë në emër të KKZHE-së dhe në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i inkurajoj të gjithë ministrat që janë udhëheqës të Task Forcave për indikatorët, që të japin maksimumin në mënyrë që masat afatshkurtëra t'i përmbysim deri me 28 shkurt të këtij viti, ndërsa masat tjera të cilat nuk mund t'i realizojmë, kemi afat deri me 31 maj 2017. Përpos respondentëve të cilët komunikojnë drejtëpërdrejtë me BB, ne kemi edhe raportimin e qeverisë i cili bëhet me 31 maj. Andaj inkurajoj të gjithë që të punojmë sipas planit që e kemi dhe ndihmës që marrim nga projekti i USAID -it.

## 4. Efektet e reformave fiskale të ndërmarra nga Ministria e Financave dhe planifikimi për reformat e ardhshme (MF)

**Ministrja Bajrami:** Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës - propozuar nga Ministri i Financave. Do të flasim për efektet e reformave fiskale të ndërmarra nga MF deri më tani si dhe planifikimet për reformat e ardhshme; fazën e dytë të reformave fiskale. Siç jeni në dijeni, në fillim të shtatorit të vitit të kaluar MF dhe Qeveria e Kosovës e ka miratuar pakon e re fiskale e cila ka kontribuar pozitivisht në aktivitetin e shumë bizneseve kosovare, sidomos atyre prodhuese. Tani pas një periudhe reflektimi, analizash dhe dialogu me komunitetin e biznesit MF është duke e përgatitur pakon e re fiskale e cila synon reforma të mëtejme, më qëllim të lehtësimit dhe afarizmit në vend. Ftoj ministrin e financave z. Hoti që të marrë fjalën.

**Ministri Hoti (MF):** Ju e dini se vitin e kaluar kemi filluar një reformë fiskale në ndërrimin e tri ligjeve bazike. Javën që shkoi në Qeveri kemi marrë një vendim, në parim, për aprovimin e këtyre masave të reja të politikës fiskale, për të filluar debatin e hapur me të gjitha palët e involvuara në biznes, në veçanti me ekspertë, me shoqërinë civile dhe me tjerë. Po shfrytëzojmë takimin e këtij Këshilli për të prezentuar këto masa, për të marrë inputet e juaja. Normalisht, ne kemi një agjendë

shumë të ngjeshur me diskutime me bizneset. Javën e kaluar kemi mbajtur një diskutim të parë me Odën Ekonomike të Kosovës, vazhdojmë me odat tjera dhe shoqatat tjera për të marrë inputet e tyre. Më lejoni që të shkoj shkurtimisht nëpër masat e ardhshme: E para, është zgjerimi i listës së lëndëve të para që lirohen nga tatimi doganor. Pra është një listë e lëndëve të para që ende ngarkohen me këtë tatim doganor. Propozimin fillestar e kemi pranuar nga Oda Ekonomike e Kosovës, në veçanti një listë të gjatë nga Oda Ekonomike Amerikane. Do e ndajmë edhe me shoqatat dhe odat tjera për të marrë propozimet nga të gjithë akterët. Presim që heqja e kësaj ngarkese do e rris importin e lëndëve të para që janë pjesë të pakos me rreth 20%, ashtu si e kemi pasë praktikë vitin që shkoi, në bazë të dhënave që kemi dhe normalisht kjo do të zvogëloj koston e prodhimit. Masa e dytë është heqja e normës së akcizës në mazut që përdoret për qëllime prodhimi. Ne kemi një vendim të qeverisë të vitit të kaluar, që u mundëson ndërmarrjeve prodhuese që përdorin mazutin për qëllime prodhimi, të rimburohet akciza. Edhe pse e kemi përmirësuar dukshëm procesin e rimbursimit apo akcizës dhe të TVSH-së dhe të taksave të tjera, mendojmë që me një listë përfundimtare të kompanive që përdorin mazutin për procese prodhimi, ne mund të lëvizim në drejtim të heqjes complete të akcizës në mazut që përdoret për qëllime prodhimi. Vlera e importit të kësaj është 7.1 milionë euro brenda vitit. Masa e tretë është ndryshimi dhe plotësimi i listës së produkteve që i nënshtrohen normës 0 % ose normës së reduktuar 8% të TVSH-së. Me pakon fiskale që ka hyrë në fuqi në shtator të vitit të kaluar, ne kemi përshkallëzuar TVSH-në nga 18% në 8% dhe kemi lënë mundësinë që bazuar në nenin 26-të të lirit të TVSH-së, në aneksin 3, është një listë e gjatë e mallrave dhe shërbimeve të ndryshme që MF ka diskrecion që t'i lëviz nga një normë tatimore të TVSH-së në normën tjetër. Këtu përfshihen në veçanti disa prej gjërave ushqimore, për konsum të njeriut dhe konsum të shtazëve. Është furnizimi me ujë të ambalazhuar, janë sojat, sheqeri i rafinuar dhe parafinuar, perimet e papërpunuara, peshqit, mishi, pijet, duke përfshirë pijet alkoolike dhe të gazuara, disa prej pemëve, transporti i pasagjerëve, leje për hyrje në teatër, shfaqje të cirqeve, koncerte, muze etj. Furnizimi i shërbimeve në rastin e shkrimtarëve, kompozitorëve, artistëve dhe të drejtat e tjera pronësore, dhe një listë bukur e gjatë e shërbimeve dhe mallrave të tjera. Pas analizave që ne do të bëjmë dhe t'i ndajmë me odat ekonomike, ne do të dalim, në janar besoj, me propozime se cilat prej mallrave, këtyre mallrave në aneksin 3, mund t'i lëvizim nga 18% në 8% të TVSH-së, për të zvogëluar barrën tatimore nga konsumatorët dhe qytetarët. Masa e katërt që është propozuar, është nxjerrja e UA për Pushime Tatimore, që buron nga ligji për të ardhurat e korporatave. Është një UA që e kemi diskutuar gjerësisht me FMN-në, por për shkak të implikimeve të mëdha buxhetore, ne e kemi shtyrë nxjerrjen e këtij udhëzimi. Tani kemi disa ide më të qarta në këtë drejtim, sa i përket përcaktimit të sektorëve që janë pak më strategjik dhe ku kemi përparësi krahasuese si ekonomi vendore që të përcaktojmë pushimet tatimore, varësisht prej nivelit të investimeve që bëhen dhe numrit të vendeve të reja të punës që krijohen. Nën pesë, është nxjerrja e akteve legislative për kontrollën dhe shënimin e miellit në qarkullimi të lirë në Kosovë, për dy qëllime: për të zvogëluar ekonominë jo-formale, në bazë të vlerësimeve që vetë ka bërë Oda Ekonomike e Kosovës me shoqatën përkatëse. Tregu joformal në këtë sektorë është bukur i madh dhe gjithashtu me qëllim të rritjes së sigurisë për konsumatorët dhe për prodhuesit, importuesit. Vendosja e banderolave në produktin e miellit nuk ka qëllime fiskale, por qëllim të mbrojtjes së cilësisë dhe të luftimit të informalitetit në këtë fushë. Masa e gjashtë është nxjerrja e akteve ligjore për trajtimin e humbjeve, prishja, avullimi apo humbja e peshës së disa produkteve. Edhe këtu kemi pasur diskutime tash një vit me biznese, shoqata të ndryshme, në veçanti te sektori i naftës. Legjislacioni vendor nuk është mjaft i zhvilluar në këtë fushë, por mendojmë përmes grupeve punuese ne të studiojmë praktikën më të mirë të BE-së sa i përket trajtimit të humbjeve në substancë të mallrave në mënyrë që mos të kenë bizneset obligime tatimore si rezultat i humbjeve

në substancë të mallrave që prodhojnë ose tregtojnë. Masa e shtatë është krijimi i disa kodeve të reja doganore për të lehtësuar procedurat e eksportit dhe importit që duhet të bëjë dogana. Tanimë e kemi edhe një propozim për këtë dhe besoj se do të bëhet ndaras me takimet me shoqatat përkatëse, varësisht se ku adresohen këto. Këto janë masat që i kemi prezantuar në qeveri dhe në parim qeveria është dakorduar për të hapur diskutimin publik për këto masa. Javën që shkoi ne kemi pasur një diskutim fillestar me OEK-në dhe disa përfaqësues të shoqatave të ndryshme brenda Odës dhe kanë dalë edhe aty disa propozime konkrete, të cilat grupi punues në MF është duke i analizuar. Janë disa masa, që s'po i quaj masa të politikave fiskale por masa administrative që e lehtësojnë të bërit biznes p.sh: përcaktimi ose emërimi i doganierëve kujdestar pas orës 18:00, në mënyrë që të mos kufizohet eksporti dhe importi i mallrave. Një propozim tjetër shumë i mirë që është dhënë prej një kompanie është që ne t'i hyjmë procesit të përfitimit të bonitetit të kompanive; të bëjmë njëfarë ratingu të kompanive vendore, në veçanti të ndërmarrjeve prodhuese, që ato të kenë përparësi në marrjen e të gjitha shërbimeve, qoftë nga ATK-ja, Dogana apo nga institucionet tjera që lëshojnë liçenca. Kemi tani një model të zhvilluar për fiskalizimin për vitin e ardhshëm, kemi avancim në këtë drejtim, edhe pse sivjet kemi bërë progres bukur shumë, por planet janë që viti i ardhshëm të jetë vit ku ne, në masë të madhe, të përmbylim çështjen e fiskalizimit. Kemi bërë progres në veçanti të fiskalizimi i pompave të derivateve. Unë jam informuar që janë mbi 360 pompa që janë fiskalizuar përfundimisht ose janë në proces të fiskalizimit, që është lëvizje bukur e madhe në këtë sektor. Nga shoqata e lojtrave të fatit është kërkuar, dhe ne në fakt e kemi në agjendë legjislative ndryshimin e ligjit për lojrat e fatit dhe nga shoqata e arëtarëve, ku janë mbi 700 zejtarë të disa qyteteve të vendit, ndryshimi i nenit 2 të UA që e rregullon arin e investueshëm dhe përcaktimin e TVSH-së në arin që është i njehsueshëm. Këto janë masat që ne i kemi aprovuar në qeveri dhe disa propozime që ne i kemi marrë në diskutimin e parë. Jemi plotësisht të hapur që të pranojmë komente dhe sygjerime nga ju. Ne do i qasemi secilit prej anëtarëve që janë në këtë Këshill për të pasur takime edhe më të ngushta në nivel të shoqatave për të dëgjuar propozimet e juaja.

**Ministrja Bajrami:** Shfytëzoj rastin që të informoj përfaqësuesit e asociacioneve të biznesit që ne kemi ftuar ministrin e financave në konferencën që nesër e kemi në regjionin e Gjilanit, dhe gjithashtu në konferencën që e kemi të premtën në regjionin e Prizrenit që t'i informojë bizneset për masat e reja fiskale, për fazën e dytë të reformave fiskale. Gjithashtu i inkurajojmë edhe asociacionet e biznesit edhe njëherë që ato të përfaqësojnë të gjitha interesat, pa marrë parasysh bizneseve të vogla, të mesme apo të mëdha, në mënyrë që të gjitha komentet dhe vërejtjet e tyre të përfshihen në këtë fazë.

## **5. Prezantimi i Masave të reformës strukturore të Programit për Reforma në Ekonomi – Zyra për Planifikim Strategjik (ZKM)**

**Ministrja Bajrami:** Qeveria e Kosovës si pjesë të dialogut për qeverisje ekonomike ndërmjet Kosovës dhe BE-së, për herë të tretë do t'i dorëzojë Komisionit Evropian Programin e Reformave Ekonomike ku përfshihet periudha afatmesme trevjeçare. Deri më tani, Zyra për Planifikim Strategjik ka punuar në hartimin e këtij dokumenti, në bashkëpunim me përfaqësuesit e ministrive, duke qenë në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin Evropian dhe OEK-në. Ne sapo e përfunduam takimin e Komisionit për planifikim strategjik me temë "Prioritizimi i masave për reforma ekonomike 2017-2019. Unë e ftoj z. Marmullakaj që të bëjë një përmbledhje të këtij procesi.

**Qemajl Marmullakaj (ZKM/ZPS):** Është hera e tretë që Qeveria e Kosovës prezanton para Komisionit Evropian Programin e Reformave Ekonomike. Ky program mbulon periudhën tre vjeçare afatmesme dhe gjatë këtij procesi, Zyra për Planifikim Strategjik (ZPS) nën koordinimin e ministrit të financave, z. Hoti, ka inicuar procesin qysh në qershor të këtij viti me lansimin e udhëzimeve nga ana e Komisionit Evropian, dhe në korrik, me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për inicimin e këtij procesi. Për përzgjedhjen e masave të paraqitura, dy studime për diagnostifikimin e rritjes janë kryer gjatë kësaj periudhe dhe janë identifikuar tre sektorë kyç të cilët janë pengesë e zhvillimit ekonomik. Mjedisi sfidues i të bërit biznes, i cili pengon rritjen e NVM-ve, IHD-ve dhe investimeve të përgjithshme, ku pengesa kyçe paraqitet qasja e kufizuar në financa, veçanërisht për NVM-të, zbatimimi i dobët i kontratave dhe informaliteti i përhapur ekonomik. Pastaj është infrastruktura e dobët, e cila kufizon eksportet dhe mobilitetin, ku masa kyçe penguese në këtë proces janë furnizimi i pamjaftueshëm dhe jo i besueshëm i energjisë elektrike dhe lidhjet e pazhvilluara të transportit, të cilat janë masa që drejtëpërdrejtë ndikojnë në zhvillimin ekonomik. Mospërputhja e arsimit dhe tregut të punës e cila zvogëlon punësimin dhe inovacionin. Për qëllim të këtij procesi, ne kemi bërë konsulta të ndryshme si me përfaqësues të institucioneve qeveritare, ku në bazë të udhëzuesit të Komisionit Evropian, i cili e ndan programin e reformave ekonomike në nëntë fusha prioritare. Qeveria ka miratuar nëntë koordinatorë të fushave të cilat e kanë bërë diagnostifikimin e sektorëve dhe në bazë të diagnostifikimit të sektorëve janë propozuar masat e përfshira në kuadër të programit të reformave ekonomike. Prej 26 masave të propozuara nga koordinatorët dhe ministritë, janë prioritetizuar deri më tani njëzet masa dhe një masë ka mbetur pjesë e diskutimeve të më tutjeshme e cila ndërlihet me ri-pyllëzimin, kadastrin pyjor dhe sistemin e menaxhimit të pronës. Për të qenë më ekspeditiv në këtë prezantim, në sektorin e parë prioritar është identifikuar dhe prioritetizuar masa e përmirësimit të prokurimit publik, nëpërmjet aplikimit të prokurimit i cili synon që përdorimin e gjerë të prokurimit publik dhe elektronik nga autoritetet qendrore dhe lokale, përmes të një sistemi adekuat të teknologjisë. Tek tregjet e energjisë, infrastrukturës dhe telekomunikacionit, janë tri masat kyçe të cilat janë prioritetizuar deri më tani dhe ndërlihen me eficientësinë e energjisë, ku synohet rritja 9% e investimeve të energjisë deri në vitin 2018 dhe zhvillimin e më tutjeshëm të kapaciteteve prodhuese të energjisë, përmes zhvillimit të kapaciteteve të reja gjeneruese dhe rehabilitimit të termocentralit Kosova B. Poashtu, shtrirja e infrastrukturës brezëgjere të rrjetit elektrik në masën 98% të ekonomive familjare deri në vitin 2021. Ndërsa në zhvillimet sektoriale bujqësia, industria dhe shërbimet. Masa e pestë, investimet në infrastrukturën bujqësore, diversifikimin e produkteve dhe mbulueshmërinë e sistemit të ujitjes me fokus përkrahjen e projekteve investive në sektorët prioritar të bujqësisë. Masa e gjashtë, rregullimi dhe konsolidimi i tokave bujqësore synon rritjen e madhësisë mesatare të fermave dhe lehtësimin e qasjes në ngastra kadastrale. Masa e shtatë, përkrahja në zhvillimin e grupimeve industriale, synon grupimet industriale të NVM-ve në sektorët prioritarë të politikës industriale të identifikuar nga ana e MTI-së. Dhe masa e tetë, zhvillimi i produkteve turistike në rajone turistike të Kosovës synon nxitjen e zhvillimit të produkteve turistike, me qëllim të rritjes së vlerës ekonomike të turizmit. Mjedisi i të bërit biznes ka të identifikuar pesë masa të cilat ndërlihen me politikat e bazuara në të dhëna, në thjeshtësimin e legjislacionit dhe sistemit rregullativ, duke përfshirë edhe vendosjen e qasjes për uljen e ngarkesave administrative për bizneset. Pastaj sigurimin e të drejtave pronësore përmes adresimit të informalitetit në sektorin e patundshmërive. Rritjen e efikasitetit të gjyqësorit ku synohet reduktimi i rasteve të grumbulluara përmes rritjes së kapaciteteve njerëzore dhe përmirësimit të sistemit të menaxhimit të rasteve. Përmirësimi i qasjes në financa për NVM-të, ku tanimë një masë veçse ka filluar të



zbatohet nëpërmjet të Fondit për Garantimin e Kredive; dhe krijimi i një agjencie të vetme për mbledhjen e të hyrave, e cila synon të përmirësojë zvogëlimin e hendekut tatimor përmes strukturave institucionale të thjeshtësuara dhe efektive për mbledhjen e të hyrave. Inovacionet dhe hulumtimet, një masë e inkorporuar e cila synon përmirësimin e kornizës së politikave strategjike dhe ngritja e kapaciteteve për hulumtime dhe inovacion, ku synim kryesor është niveli, rritja e nivelit të pjesëmarrjes së institucioneve shkencore të vendit në programet dhe projektet evropiane dhe rajonale. Tregtia e jashtme dhe lehtësimi i investimeve si sektorë ka të identifikuuar dy masa: rritja e efikasitetit për kostot e transaksioneve ndërkombëtare tregtare - synon të rris efikasitetin e transaksioneve të tregtisë ndërkombëtare nëpërmjet thjeshtësimit dhe standardizimit të gjitha formaliteteve dhe përmirësimi i infrastrukturës së cilësisë, e cila adreson modernizimin e infrastrukturës së cilësisë përmes bizneseve, standardizimin e infrastrukturës ligjore, metrologjike, akreditimin dhe organet e vlerësimit të konfirmimit. Arsimi dhe shkathhtësitë, ku janë të identifikuara dy masa të cilat ndërlidhen me harmonizimin e ofertës dhe kërkesës përmes hartimit të standardeve të profesionit dhe rishikimin e kurrikules ekzistuese. Gjithashtu, synohet hartimi i kurrikulave të reja, bazuar në fushat prioritare. Zbatimi i përmirësimit të sistemit të karrierës përmes mësimdhënjes, objektivë e së cilës është zbatimi i sistemit për zhvillimin profesional dhe vlerësimin e performancës së mësimdhënësve. Tregu i punës ka një masë, e cila shërbimet publike për punësim nëpërmjet krijimit të një agjencie për punësim dhe ngritjen e kapaciteteve të saja, ndërsa masa e njëzet ka përfshirjen sociale, ka një masë përmirësimin e shërbimeve sociale dhe shëndetësore e cila synon përmirësimin e shërbimeve shëndetësore nëpërmjet përcaktimit të sistemit të qëndrueshëm për ofrimin e shërbimeve sociale, si dhe fondin e sigurimeve shëndetësore. Këto janë masat të cilat janë prioritetizuar deri më tani, dhe siç e thashë është edhe masa e ri-pyllëzimit e cila duhet të diskutohet prapë me Ministrinë e Bujqësisë. Ndërsa, për hapat e ardhshëm se çfarë do të bëhet në këtë proces, përveç prezantimit në këtë forum, dokumenti do t'i nënshtrohet prezantimit edhe te shoqëria civile dhe komisioneve relevante parlamentare. Pastaj, nga mesi i janarit të vitit të ardhshëm do të miratohet në qeveri dhe do t'i dorëzohet Komisionit Evropian për konsultime shtesë. Ky dokument që nga sot do të jetë i gatshëm për ju në ueb faqen e ZKM-së dhe të MF-së, për komentet e mundshme të juaja, dhe poashtu do të ju dërgojmë edhe ftesat në koordinim me MF, do të ju dërgojmë edhe ftesa për pjesëmarrje në takim, prezantimin që e bëjmë me shoqërinë civile.

**Ministrja Bajrami:** Edhe masat të cilat eventualisht mund të largohen, ato gjithsesi nuk do të largohen nga agjenda e qeverisë. Mund të largohen, domethënë nga programi i reformave ekonomike, por gjithsesi mbesin prioritetet në fushat e tjera, siç është çështja e ri-pyllëzimeve. A dëshiron dikush ta merr fjalën lidhur me këtë pikë? Domethënë dokumentin do ta kemi në diskutim publik për komente.

## 6. Ndryshimi i Ligjit të Punës (OEA)

**Ministrja Bajrami:** Siç e kemi theksuar edhe më herët, KKZHE është platformë e cila kultivon dialogun publiko-privat dhe forum ku prezantohen ide/propozime për reformat të cilat kanë për ide përmirësimin e politikave tona publike në funksion të përmirësimit të mjedisit afarist. Në këtë pikë, Oda Ekonomike Amerikane do ta sjell propozimin për pikëpamjet e saj për ndryshimin e Ligjit të Punës.

**Visar Hapçi (OEA):** Kam kënaqësinë të prezantoj njëren prej dokumenteve që ka paraqitur OEA për diskutim në KKZHE. Politikat e punësimit dhe nevojat për ndryshimin e Ligjit të Punës do të

jenë në fokus të prezantimit tim. Krijimi i një tregu fleksibil të punës nxit konkurrencën dhe rrit produktivitetin brenda sektorit privat dhe është shumë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit. Politikat e punësimit luajnë gjithashtu rol shumë të rëndësishëm edhe në konkurrueshmërinë e Kosovës karshi vendeve të rajonit e sidomos kur e kemi fjalën për tërheqjen e IHD-ve. Qysh në 2010, kur edhe është miratuar Ligji i Punës, OEA ka qenë shumë aktive me ofrimin e shumë komenteve në nene specifike; si duhet të rregullohen fusha specifike që i trajton Ligji i Punës. Mirëpo, me keqardhje e them që shumë nga komentet që i kemi dhënë nuk janë marrë parasysh. Kërkesën për të ndryshuar Ligjin e Punës e kemi paraqitur pikërisht në këtë Këshill, atëherë ka qenë me një format tjetër në vitin 2012. Sot ndodhemi në një situatë kur ka pakënaqësi të shumta me këtë ligj dhe veçanërisht shqetësues fakti që numri i të punësuarave femra në moshën 25 - 34 vjeçe dhe në moshën 35-44 vjeçe ka rënë. Sipas anketës për fuqinë punëtore, nga viti 2013 deri në vitin 2015, numri i të punësuarave femra, në këto kategori që i përmenda ka rënë prej 21 000 në 18 000, gjegjësisht 17 500 persona. Mendoj që kjo është një e dhënë shqetësuese dhe ia vlen të diskutohet mënyra se si të adresohet ajo. Në mënyrë që të realizohet synimi për krijimin e një tregu më fleksibil të punës, të evitohen këto raste që i përmenda në punësim, që rrjedhin si rrjedhojë e politikave. OEA e rithekson thirrjen që duhet të përshpejtohen hapat për amendamentimin e Ligjit të Punës. Ne e dijmë se më shumë se gjashtë muaj është një draft, që MPMS e ka nxjerrë në diskutim publik dhe mendojmë që duhet të ecet më përpara me procesin e amendamentimit të ligjit. Meqenëse e kemi dërguar paraprakisht dokumentin tek ju, nuk do të kisha hy në detaje në secilat pika, por duhet të prezantojë 3 pikat kryesore të cilat ne i shohim të rrugës. E para është, atë që e thashë, meqenëse po shihet që Ligji i Punës ka nxitur diskriminim në mesin e punëtorëve që janë në moshën e shtatëzanasë. Në draftin që është dërguar nga MPMS para ca muajve, muaji prill i këtij viti, është theksuar që është planifikuar të shkurtohen në 9 muaj, ku sistemi do të jetë 3+3+3, jo siç është tani 6+3+3. Ne si OEA e kemi mbështetur këtë propozim me mendimin që një ndryshim i tillë i mundshëm do të përmirësonte situatën sa i përket punësimit të grave në mesin e ndërmarrjeve private në Kosovë. Pika e dytë ka të bëjë me marrëveshjen kolektive. Të gjithë kemi qenë dëshmitarë të ngecjeve dhe paqartësive që ka pasë ky proces që në kohën kur është nënshkruar për herë të parë në Këshillin Ekonomik Social. Ka pasur shumë ankesa nga bizneset anëtare të OEA që e kanë parë të pakuptimtë mundësinë që një palë e tretë të hyj në marrëdhënie, në detyrime qoftë financiare apo detyrime tjera, pa qenë vetë nënshkrimi i tyre në atë marrëveshje. Prandaj e kemi parë të arsyeshme të propozojmë që marrëveshja kolektive, si të themi e limituar me marrëveshjen që nënshkruhet mes punëdhënësve dhe organizatat e punëtorëve të atij punëdhënësi, domethënë të jetë marrëveshje kolektive e limituar në nivel të ndërmarrjes. Si pikë e tretë do të ishte drafti i dërguar nga MPMS, që ka paraparë që kontratat me afat të caktuar të jenë të kufizuara deri në tre vjet. Me ligjin e tanishëm afati është dhjetë vjeçar. Mendojmë që një politikë e tillë e prish fleksibilitetin që e përmendëm deri tani në tregun e punës. Ka shumë kompani që p.sh. zhvillojnë projekte pesë-vjeçare apo tre-vjeçare dhe kanë nevojë që punësimin ta bëjnë për një afat më të gjatë se ajo periudhë tre vjeçare, por jo domosdo të jetë kontratë me kohë të pacaktuar. Prandaj, mendojmë që nuk duhet ndryshuar ligji aktual në këtë fushë.

**Ministrja Bajrami:** Ligji i Punës dhe sidomos tema e lehonisë ka qenë çështje e diskutimit në shumë tryeza, dhe atë çfarë kemi dashur është që të kemi analizë dhe evidenca që të shohim se cili ka qenë impakti, a ka qenë impakt pozitiv apo negativ. Siç e dini kur është ndryshuar, qëllimi ka qenë i mirë, për të ndikuar pozitivisht në natalitet, për të ndikuar pozitivisht edhe në mirëqenie të nënave dhe të fëmijëve. Mirëpo, në qoftë se kjo ka konsekuenca negative sa i përket punësimit të gruas, i cili gjithashtu është në disavantazh me gjininë tjetër,

atëherë ne duhet të planifikojmë që ta ndryshojmë këtë ligj. Unë hap diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës, por paraprakisht, ndoshta, meqenëse ligjin e kemi në diskutim dhe sigurisht MPMS ka marrë komentet nga të tjerët, por edhe nga OEA, unë kisha kërkuar nga zv. Ministri fillimisht të marrë fjalën dhe mandej në qoftë se të tjerët kanë diçka për të diskutuar.

**Hasan Hasani** (Zv. Ministër - MPMS): Ne si ministri do t'i kemi parasysh të gjitha këto vërejtje që janë dhënë; propozime për ndryshime, dhe mendoj se edhe Ministri Abrashi është në ngjarje për këtë. Të gjitha vërejtjet në këtë drejtim, për ne do të jenë të obligueshme dhe do të jenë në interes të gjinisë e cila, siç e tha edhe ministrja Bajrami, ka nevojë për të pasur kujdes, gjininë e cila ka nevojë për shumë gjëra të cilat edhe e diskriminojnë në shumë aspekte. Mendoj që ky ligj duhet të jetë edhe në favor të gjinisë femërore.

## 7. Maksigrafi: Përdorimi në Kosovë dhe krahasimi me rajonin (OEA)

**Ministrja Bajrami:** Pika e propozuar nga OEA, në fakt, në këtë pikë kemi punuar bashkë me OEA. Qe dy vite gjatë takimeve që i kemi me komunitetin e biznesit çështja e sigurimit të energjisë elektrike ende mbetet një çështje për t'u zgjidhur dhe për të punuar. Ajo çfarë do të diskutojmë dhe do të dëgjojmë analizën që ka bërë OEA, është çështja e maksigrafit. Maksigrafi, siç e dini, është një mbeturinë e sistemit socialist, atëherë kur fitimi i një ndërmarrje ka mbuluar humbjen e një tjetre, mirëpo asesi nuk është e pranueshme nga sektori privat dhe ekonomia e tregut sot. Sot ndërmarrjet tona nuk dëshirojnë të paguajnë fatura të paragjykuara të energjisë elektrike. Ato dëshirojnë të paguajnë saktësisht kilovatët të cilët i harxhojnë. Maksigrafi është pajisje e cila mat maksimumin brenda një periudhe kohore dhe i bënë ndërmarrjet që të paguajnë në bazë të atij maksimumi. Nëqoftëse ai maksimum është arritur vetëm disa orë brenda ditës, fatura vjen e paragjykuar, thua se ata kanë shfrytëzuar atë kapacitet pothuajse gjatë gjithë muajit. OEA ka bërë një analizë në vendet e rajonit, do të thotë, të na sjell praktikën dhe gjithashtu është kërkesë edhe e Odës por edhe kërkesë e MTI-së për ZRRE-në që maksigrafi përfundimisht të largohet dhe ndërmarrjet tona të paguajnë rrymën të cilën e shpenzojnë dhe jo fatura të paragjykuara. Përfaqësuesi i OEA e ka fjalën për të prezantuar praktikën e vendeve të rajonit.

**Vanesa Gashi** (OEA): OEA ka përgatitur një hulumtim rreth çështjes së maksigrafëve në Kosovë, po ashtu edhe praktikave në vendet e rajonit, duke qenë edhe një ndër shqetësimet kryesore të bizneseve, e posaqërisht atyre prodhuese. Edhe pse pajisja për kontrollimin automatik - maksigrafi - është dizajnuar me qëllim të uljes së kostos së prodhimit, sistemi aktual i përdorimit të maksigrafit në Kosovë mund të quhet joeficient, për arsye se kostoja e energjisë elektrike matet vetëm në bazë kohore, ditore apo sezonale. Duke pasur parasysh që kërkesa për prodhimin e produktit të caktuar dhe si rezultat çmimi i produktit final rritet për arsye se kjo kërkesë nuk varet direkt nga koha, d.m.th. në baza ditore apo sezonale, prodhuesit ose blerësit apo konsumatori i produktit final dëmtohet në këtë rast duke e paguar një çmim më të lartë. Poashtu kostoja e elektricitetit për një ndërmarrje e cila funksionon vetëm me një gjysmë orari, dhe që i nënshtrohet në mënyrë të plotë maksigrafit, atëherë kostoja e energjisë elektrike për atë kompani rritet në mënyrë drastike duke e dëmtuar konsumatorin dhe vet kompaninë. Edhe sipas një raporti të Bankës Botërore mbi shfrytëzimin e alternativave të furnizimit të energjisë elektrike në Kosovë, parashihet që deri në vitin 2025 kërkesa për kapacitete të energjisë elektrike deri në 1500 Megawat. Duke pasur parasysh edhe kapacitetet e tanishme që ka Kosova, parashihet që deri në vitin 2025 do të ketë deficit ose do të ketë boshllëk në mes të kërkesës dhe ofertës prej 1000

Megawat. Raporti i BB poashtu ka rekomanduar krijimin e kapaciteteve të reja të energjisë së ripërtrishme. Një opcion tjetër do të ishte importimi i energjisë elektrike në vend. Sistemi i tarifave të energjisë elektrike në Shqipëri bëhet përmes sistemit të kulminacionit të ngarkesës i cili aplikohet prej periudhës dhjetor deri në janar, përkatësisht nga dita e martë deri të enjten, prej orës 20:00 deri në orën 21:00. Kulminacioni i ngarkesës në Shqipëri për dallim nga Kosova, bëhet sipas sinkronizimit të ngarkesës maksimale të konsumatorëve të ndryshëm e cila si rezultat e krijon një lloj mesatarje gjatë kohëve të caktuara brenda ditës, dhe pastaj ajo aplikohet si tarifë e konsumit të energjisë elektrike. Prioritet i rëndësishëm i entit rregullator të energjisë në Shqipëri, dhe arsyeja se pse këto tarifa janë aplikuar në Shqipëri ka qenë, ose qëllimi kryesorë ka qenë dekurajimi i shtimit të energjisë elektrike për ngrohje, duke pasur parasysh që Shqipëria ka mungesë të energjisë elektrike dhe shumicën e energjisë elektrike duhet ta importoj, gjë e cila e rrit edhe me shumë koston e energjisë elektrike në Shqipëri. Duke pasur parasysh se në tregjet rajonale aplikohet tarifa sezonale, Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri ka bërë një lloj analize në vend, dmth vetëm për Shqipërinë, dmth ka arritur në përfundim që praktika të tilla nuk duhet të ndiqen dhe si rezultat atje nuk aplikohen maksigrafët. Në anën tjetër sistemi i tarifave në Maqedoni për shitje dhe të energjisë elektrike për konsumatorë të tarifuar përcaktohet në bazë të kategorizimit të këtyre përdoruesve apo konsumatorëve të energjisë elektrike, dhe poashtu në bazë të sistemit të tensionit të kohës kur përdoret energjia elektrike dhe sipas llojit të matjes. Sistemi i kulminacionit të energjisë elektrike në Maqedoni gjatë sezonit të dimrit, përkatësisht prej periudhës dhjetor-janar përmes maksigrafëve. D.m.th. në Maqedoni aplikohen maksigrafët, mirëpo momentalisht në Maqedoni, qeveria e Maqedonisë, përkatësisht Ministria e Ekonomisë është përgjegjëse për politikën dhe zhvillimin e energjisë elektrike, ndërsa në anën tjetër Komisioni Rregullator i Energjisë është organ i pavarur dhe kompetent për rregullimin e tregut në sektorin e energjisë. Ndërmarrjet kryesore të cilat operojnë dhe bëjnë shpërndarjen e energjisë elektrike në Maqedoni janë kryesisht ndërmarrje publike, dhe vetëm një pjesë e vogël e tyre të cilat bëjnë shpërndarjen e energjisë janë private. Sistemi i tarifave të energjisë elektrike në Serbi bëhet përmes ngarkesës në pagesë, e cila është e njëjtë në çdo muaj, pavarësisht sezonës ose kohës edhe në sezonën kur shfytëzimi i energjisë elektrike është më i vogël. I gjithë sistemi i shpërndarjes së energjisë elektrike në Serbi është publik, i themeluar nga vetë shteti. Për të zvogëluar pagesat e energjisë elektrike në Serbi aplikohet sistemi i matjes së energjisë në afat ose në një interval kohor brenda ditës, përkatësisht prej 15 deri në 30 min, dhe ajo matje evidentohet në sistemin e të dhënave, e cila pastaj llogaritet si tarifa e cila duhet të paguhet. Sidoqoftë, sipas agjencisë së energjisë në Serbi kushti kryesor për reformat e sistemit të çmimeve është klasifikimi i sektorëve në bazë të aktiviteteve të operimit të tyre, në bazë të tensionit të energjisë elektrike që një sektor i caktuar kërkon dhe në bazë të qëllimit të shfrytëzimit të energjisë elektrike. Të gjitha tarifat në Serbi maten përmes matësve apo të ashtuquajturve maksigraf dhe tarifat e larta fillojnë nga ora 07:00 e mëngjesit deri në orën 23:00. Sidoqoftë këto çmime, kalkulimi i kategorive ose sektorëve në të cilin operon një industri e caktuar. Si përfundim, OEA në Kosovë rekomandon heqjen e tërësishme të maksigrafëve duke pasur parasysh kërkesën e të gjithë bizneseve, bizneseve që merren me prodhimtari dhe poashtu duke pasur parasysh edhe politikën në vendet e rajonit të cilat i konsiderojmë se janë më të favorshme sesa në Kosovë.

**Ministrja Bajrami:** Sekretariati i KKZHE-së duke parë natyrën e pikave të cilat do të ngriten, konform rendit të ditës ka ftuar zyren e ZRRE-së. Kemi këtu z. Pepaj. Ju keni pasur i nderuar edhe agjendën, por gjithashtu edhe materialet paraprakisht. Andaj, ne kërkojmë një përgjigje rreth kësaj çështje. Gjithashtu, kjo çështje nuk është ngritur vetëm nga OEA, por komplet nga komuniteti i biznesit, me të gjitha diskutimet që ne i kemi pasur gjatë dy viteve. Ne kërkojmë

përfundimisht që të ketë një trajtim pozitiv dhe kërkojmë një zgjidhje për këtë çështje, siç e thashë, bizneset dëshirojnë të paguajnë vetëm sasinë e energjisë elektrike të cilën e shpenzojnë. Ne, tani duhet të dijmë që distribucionin e energjisë elektrike e kemi privatizuar, nuk është më ndërmarrje publike, dhe në fakt duhet të jetë si shërbim në të mire edhe të sektorit privat. Ne e kemi ngritur këtë çështjen e maksigrafit me zyren e ZRRE-së edhe në raste të tjera, kur kemi ngrit edhe tarifën e kyçjes në energji elektrike, kalimin e asetëve siç janë trafostacionet etj. në pronësi të KEDS-it në momentin kur ato kyçen etj. Ndër të tjera është ngritur edhe çështja e maksigrafit, por nuk është trajtu dhe tani dëshirojmë që kjo të trajtohet.

**Petrit Pepaj (ZRRE):** ZRRE e ka të përcaktuar me ligj përcaktimin e tarifave të energjisë elektrike. Ndërsa me ligjin e ri tarifën për një pjesë të konsumatorëve ose sidomos konsumatorët e biznesit do t'i nënshtrohen tregut të ri të liberalizimit; nuk do të jenë pjesë e rregullimit nga ZRRE. Ne kemi përgatitur edhe udhëzuesin për liberalizimin e tregut, të cilin do ta shpërndajmë edhe me bizneset, por edhe me palë tjera të interesit. Nga fillimi i vitit të ardhshëm ose me 31 mars të vitit të ardhshëm çmimet e gjenerimit nuk do të rregullohen më, do të jenë çmime që do t'i nënshtrohen konkurrencës. KEK-u do të jetë i obliguar përfundimisht, që të ofrojë kapacitetin e tij tek furnizuesit të cilët operojnë në Kosovë. Momentalisht i kemi tre furnizues të cilët janë të licencuar në Kosovë. Njëri është KESCO, ndërsa janë edhe 2 tjerë, njëri nga Kroacia - HEP-i dhe tjetri është nga Shqipëria - GSA, të cilët kanë shprehur interes të operojnë në Kosovë. Ne kemi përcaktuar edhe rrugën të cilën do ta ndjekim për shtyerjen konsumatorëve të biznesit që të negocijojnë tarifën me furnizues të tjerë, dhe jo të jenë me pjesë e tarifave të rregulluara. Deri me 31 mars të këtij viti, konsumatorët të cilët janë kyçur në nivelin e transmisionit siç është: Ferronikel-i, Sharrcem-i dhe Trepça do të jenë detyrimisht të obliguar ta negocijojnë çmimin me një furnizues të cilin do e gjejnë në Kosovë. Vitin tjetër, varësisht nga rrethanat që do të krijohen, konsumatorët në nivelin 35 dhe 10, edhe ata do të shtyhen, nuk do të nxiten më të jenë pjesë e tarifave të rregulluara. ZRRE-ja do të rregullojë vetëm tarifën për konsumatorët për shërbime univerzale, që janë shërbime jetike për konsumatorë familjar dhe për furnizuesin e garantuar. Ne kemi trajtuar çështjen e maksigrafit edhe gjatë periudhave, po i kthehem pak historisë edhe viteve të kaluara. Maksigrafi është pajisje matëse e cila luan funksionin e njëjtë si çdo pajisje tjetër në botë, dhe ka qëllimin e njëjtë. Nuk ka qëllim të ndryshëm në Kosovë krahasuar me vendet e rajonit. Qëllimi është që bizneset në Kosovë përbëjnë 30 % të konsumit total të vendit, ndërsa 70% është konsum prej amvisërisë. Bizneset nuk e kanë prodhimin në mënyrë kontinuale që punojnë me tre ndërrime por disa punojnë me një ndërrim, disa punojnë me dy ndërrime, disa për kohë të caktuar të prodhimit, varësisht si e kanë. Në këto raste maksigrafi ka mundësi të demtu, mirëpo te bizneset të cilët e kanë prodhimin gjatë tre ndërrimeve, ajo nuk ka mundësi të demtojë për shkak se fillon dhe e mat çdo 15 minuta maksimumin e energjisë ose kapacitetin e cili e tërheq. Kjo është çështje që është trajtuar prej ZRRE-së, dhe ata konsumatorë të cilët do të mbesin në tarifa që do të jenë me shërbime univerzale, me siguri do ta trajtojmë dhe nuk do të ketë më çmim, por çmimi do të jetë i kombinuar. Në secilin vend të botës, nëse nuk ka çmim të specifikuar për atë kapacitet, e ka një çmim të kombinuar me një tarifë tjetër. Domethënë është e pamundur mos me e pasë koston e kapacitetit një shtet i cili funksionon në një sektor. Ne mundemi me e heq si tarifë, dmth si tarifë fikse që është, edhe që përcaktohet, që mundet me u kombinuar me një tarifë tjetër e cila mundet me mbulu konsumin, por në asnjë rast dhe asnjë rrethanë jo me e demtu biznesin apo konsumatorin. Ne do të jemi shumë të kujdesshëm gjatë shqyrtimit të ardhshëm, siç kemi qenë edhe në të kaluarën, p.sh. në vitin 2014 nuk ka pasur rritje të tarifave fare, ndërsa në vitin 2015 ka një zbritje prej 8 % të konsumatorët e biznesit. Dhe nëse e marrim e krahasojmë çmimin që e paguajnë bizneset në Kosovë me çmimet që paguajnë bizneset në rajon, Kosova është ndër

vendet me çmimet më të ulëta. Kjo mund të shihet sipas grafikave dhe të dhënave zyrtare që janë të publikuara. Vetëm Serbia e ka çmimin më të lirë se Kosova, ndërsa gjitha shtetet tjera të rajonit dhe më gjerë kanë çmim shumë më të lartë për biznese sesa ka Kosova. Këto janë statistikat të cilat janë të publikuara dhe janë zyrtare, të publikuara në webfaqen e asociacionit të rregullatorëve të Evropës Jug-Lindore. Nuk është çmimi i lartë për biznes në Kosovë. Është problem mungesa e energjisë elektrike që është e theksuar; ka qenë e theksuar; tash ka përmirësime, por jo përmirësime në atë masën e duhur. Ne do ta trajtojmë çështjen e maksigrafit për të gjithë ata konsumatorë të cilët do të mbesin konsumatorë që zyra e ZRRE-së ka me e rregullu çmimin. Ndërsa për ata konsumatorë që kanë me qenë të shtyer me zgjedh furnizuesin do të jenë të kujdesshëm kur të fillojnë negociatat për caktimin e çmimit.

**Ministrja Bajrami:** Z. Pepaj, meqenëse i ke diskutuar shumë tema, edhe nuk morrëm përgjigje konkrete, d.m.th. e keni diskutu, do ta diskutoni. Këtë përgjigje e kemi nga ZRRE-ja që dy vite, e keni diskutu dhe do ta diskutoni. E thatë vetë që të gjitha ndërmarrjet të cilat nuk punojnë me tri ndërrime dëmtohen nga maksigrifi. Fatkeqësisht numri më i madh i ndërmarrjeve nuk punon në tri ndërrime. Nuk e di ju a i keni shifrat se sa ndërmarrje në Kosovë punojnë me tre ndërrime. Ne jemi treg i vogël, nuk kemi mbërri ende me depërtu në tregjet e huaja. Po bëjmë përpjekje, dhe ne për këtë arsye duhet të kemi masa stimulative dhe jo masa ndëshkuese. Pyetja është që kur ktheheni në zyre, ta diskutoni edhe me eprorët e juaj se si ka mundësi të largohet komplet maksigrifi dhe bizneseve t'iu ofrohen mënyra të tjera për tarifat e energjisë. Ne po flasim për një vazhdimësi të sistemit, derisa ekonomia ka ndërruar, nuk është më ekonomi socialiste. Sot përqindja e sektorit publik është shumë e vogël në krahasim me sektorin privat. Po flasim për sektorin privat i cili dëshiron me i pagu faturat e veta dhe nuk dëshiron me i pagu faturat e ekonomisë familjare. Maksigrifi është i kohës kur 70% e energjisë elektrike në Kosovë është konsumuar nga industria dhe 30% nga ekonomia familjare. Sot e kemi të kundërtën, kemi 70% ekonomi familjare dhe 30% industri. Ne si KKZHE kërkojmë që kjo çështje të trajtohet dhe në mbledhjen e radhës të KKZHE-së të vini me propozime konkrete. Mirëpo, gjithashtu një nga task forcat për të bërit biznes që kryesohet nga Besian Mustafa do të ju kontaktojë dhe në ndërkohë, në mënyrë që të jemi në kontakt edhe me asociacionet e biznesit që të kemi një ofertë konkrete për bizneset. Domethënë ne kemi një ndryshim të sistemit ekonomik dhe nuk mund të vazhdojmë me një sistem të vjetër sepse, thjeshtë nuk përkon tani me konjunkturën ekonomike të vendit. A ka dikush që dëshiron ta marrë fjalën sa i përket kësaj pike?

**Muhamet Mustafa** (Kuvendi i Kosovës): Kjo është një çështje që është ngritur nga bizneset vazhdimisht, kjo edhe çështja e tarifave verë-dimër janë dy anomali të mbetura në sistemin e përlllogaritjes së çmimeve, kur llogariten të ardhurat maksimale për ZRRE-në. Problemi me tarifat tona është se ka një shpërndarje të obligimeve nga familjet te ata që konsumojnë më shumë, nga familjet që konsumojnë më pak. Subvencionohen nga të gjithë konsumatorët që konsumojnë më shumë. Ky është sistem i tillë i përlllogaritjes së çmimeve dhe reformimi i tij është jo shumë i lehtë. Natyrisht që ZRRE-ja është e pavarur, por duhet të jetë në funksion të pozitës konkurruese të bizneseve. Dy anomalitë duhet të evitohen, dmth deri në mars. Çështja e maksigrafit duhet të studiohet, dhe vendimet për tarifa të reja definitivisht duhet të zgjidhen. I ka zgjidhur me liberalizim të tregut, por liberalizimi i tregut nuk i kap si duket pjesën më të madhe të bizneseve, së paku jo në vitin e ardhshëm. Prandaj kjo çështje duhet të zgjidhet edhe kjo është konkluduar edhe në mbledhjen e fundit të komisionit të cilit e kemi diskutuar çështjet e furnizimit dhe problemet e reja që ishin në furnizimin. E dyta, tarifa verë-dimër për biznese nuk ka kuptim. Domethënë sepse bizneset kanë një konsum kontinuel si verës si dimrit. Në qoftëse ju rritet çmimi dimrit, dhe verës kjo po krijon problem në cashflow-un e tyre. Prandaj duhet të gjindet një çmim

mesatar për biznese që është njëjtë gjatë tërë vitit, pa marrë parasysh a është verë apo dimër. Kjo nuk është ndonjë problem që të rregullohet, besoj që rregullohet. Pra, duhet të zgjidhet sepse unë para disa kohe isha në një fabrikë të miellit. Ata mund të shfrytëzojnë kapacitetet 50%, nëqoftëse do të shfrytëzonin më tepër i godet maksigrafi, edhe nuk kanë llogari me shfrytëzu kapacitetin me shumë se 50%. Ky është një absurditet që duhet të zgjidhet. Tash ZRRE-ja duhet të krijoj një nivel të ardhurave maksimale, por duhet të shoh një shpërndarje më të drejtë të kriterëve brenda këtij çmimi që i siguron të ardhura maksimale. Edhe këto janë kërkesat edhe të Komisionit, natyrisht që ata tash duhet në mënyrë të pavarur të rregullojnë, por të jenë në funksion të aftësive konkurruese të biznesit.

**Agim Shahini (AKB):** I nderuari tha se energjia elektrike është zbritur 8%, dhe a e din a e ka vërejtur dikush këtë zbritje të energjisë elektrike, përkundrazi faturat vazhdimisht janë rritur. Ju e dini se pse e keni rritur një vit më herët, dy herë energjinë elektrike. Ju e dini që Qeveria e Kosovës ka marrë vendim të ul TVSH-në, dhe ajo ulje e TVSH-së nuk është vërejtur për shkak të rritjes së çmimeve TVSH-së, dhe gjithë kjo ju ka favorizuar juve që të na furnizoni me energji elektrike, por ndërpreja e energjisë elektrike dhe shtrenjtimi i saj po vazhdon edhe sot. Andaj po vazhdojnë pakënaqësitë e bizneseve por edhe të qytetarëve ndaj juve.

**Ministri Stavileci (MZHE):** Ndoshta jo vetëm për këtë çështje, por edhe për të tjerat, është mirë që qysh vitin e kaluar, kur disa muaj para shqyrtimit të rregullt të ZRRE-së që e bënë para se të nis viti energjetik me 1 prill, pra të secilit vit rrjedhës, të takohemi apo ndoshta ta shfrytëzojmë përparësinë e këtij forumi, ku janë pothuajse të gjitha bizneset e përfaqësuara, që në mënyrë përmbledhëse të dërgohen kërkesat e tyre, mendoj që është më e mirë, më e drejtë edhe më e lehtë, sepse duke bërë vizita individuale, gjë të cilën unë e kam bërë shpesh, sidomos duke qenë në cilësinë e ministrit të Bujqësisë, por edhe tash e shohim që jo gjithëherë janë të arsyetueshme. Në këtë rast këtu e kemi platformë të pothuajse të gjitha bizneseve, siç më kujtohet, besoj edhe Kryeministrit i kujtohet vitin e kaluar kanë qenë të përmbledhura tetë pika. Ka qenë edhe kjo e maksigrafit dhe të merren masat me kohë, në mënyrë që viti i ri energjetik të nis me ndryshime kualitative dhe kuantitative. Dhe besoj që këtu do të jetë edhe një përparësi, miratimi i pakos së tretë të ligjeve për energjinë, pra Ligji për Energjinë Elektrike dhe Ligjit për Rregullatorin, ku ne në kuadër të masave të buta e kemi bërë ndoshta ose po e bëjmë një reformë edhe më të shpejtë sesa vendet e tjera të Evropës Jug-Lindore, i kanë dhënë vetes afat gati tre vite për t'i konvertuar këto reforma në diçka praktike në funksion edhe të bizneseve edhe të ekonomive familjare, kurse ne i kemi dhënë vetes nëntë muaj dhe menjëherë janë parë rezultatet e para. Pra, sot i kemi të licencuar tre furnizues, që besoj është një përparësi për biznesin, si dhe ato që u thanë nga ZRRE-ja. Po mendoj që më e mira, meqë ZRRE-ja e ka këtë funksion, e kemi këtu edhe kryetarin e Komisionit Parlamentar, edhe Kryeministrin, edhe përfaqësuesit e bizneseve, sikurse kjo çështje që u ngrit, është ngritur edhe herave të tjera. Ta bëjmë përsëri një listë të tillë ku do të takoheshim dhe do t'i bashkërendonim të gjitha këto aktivitete në mënyrë që viti që vjen, përsëri të na gjejë më një reformë të ri-freskuar në dobi edhe të bizneseve, ekonomive familjare edhe të qytetarëve.

**Kryeministri Mustafa:** Vitin e kaluar ne jemi takuar me ZRRE-në; kemi biseduar disa prej prokupimeve dhe vërejtjet që kanë pasur bizneset. Mendoj që vitin e kaluar kemi gjetur një zgjidhje dhe masat që janë marrë pastaj kanë qenë masa që e kanë përmirësuar edhe pozitën e bizneseve. Tani kjo çështje që u ngrit nga OEA, edhe çështjet që u ngriten u zgjeruan pak nga Kryetari i Komisionit për Ekonomi të Kuvendit z. Mustafa, janë çështje që mendoj që meritojnë të shtrohen në tavolinë. Unë jam i gatshëm si Kryeministër, së bashku me Kryetarin e Komisionit të Kuvendit, me ministrin e MZHE-së, me ministren e MTI-së, përfaqësuesit e odave të ulem me

ZRRE-në, të ulemi para se t'i përcaktojmë politikat e energjisë për vitin e ardhshëm para muajit prill, ta shohim si me e zgjidh këtë çështje. Unë nuk jam për atë që këto probleme t'i shohim apo zgjidhim në mënyrë të njëanshme. Ne duhet ta ruajmë me çdo kusht pozitën e bizneseve, edhe ata nuk duhet t'i dëmtojmë në pikëpamje të energjisë elektrike. Tani po bashkëbisedoja me zv. Kryeministrin Kelmendi, si biznesmen i llogarit edhe në mënyrë matematikore, racionale se si bëhen ato dhe po thotë se, nëse të gjithë motorët ndezen në të njëjtën periudhë pastaj kemi problem, sepse bëhet ngarkesa shumë e madhe dhe e qesim prej sistemit bllokun. Por si ta krijojmë disiplinën te bizneset, të krijohet racionaliteti në aktivizimin e makinave ose gjeneratorëve. Dhe që kjo pastaj mos ta dëmtojë, por në asnjë rast të dëmtohen bizneset, poashtu të mos dëmtojmë as KEDS-in as bizneset. Por mos t'i lejojmë askujt që tash në llogari të bizneseve të zgjidh problemet e veta. Unë e di që ZRRE-ja është organ i pavarur; të gjithë ne jemi në një formë të pavarur, por të gjithë ne duhet të mendojmë për ekonomi. Sepse në qoftë se nuk e kemi, nuk sigurojmë një zhvillim ekonomik, atëherë nuk mund ta mbajmë as pavarësinë tonë institucionale. Kështu që në këtë aspekt, unë si Kryeministër që së bashku me ju të ulemi, ta bisedojmë këtë çështje, ta ofrojmë një zgjidhje edhe që në politikat e ardhshme të cilat ZRRE-ja do t'i shpall dhe do t'i aplikoj karshi ndryshimeve ligjore të cilat janë bërë të gjejnë mundësi ta plotësojnë këtë kërkesë.

**Zv. Kryeministri Kelmendi:** Zakonisht maksigrafi është montuar që të nxjerret një energji mesatare e konsumit kontinual të një periudhe të caktuar kohore, për të pasur një planifikim, sa ka nevojë për furnizim në kohëra të caktuara - të ndryshme. Por, në momentin që ai koficient përcaktohet, çdo herë që ai koficient tejkalohet, duhet marrë vetëm ndryshimi i tejkalimit dhe ai tejkalim të jetë ndoshta jo ndëshkues, por të jetë nga një çmim më i lirë ekonomik i cili e favorizon atë që e ka profesionalizëm në kyçjen e makinerive të ndryshme dhe me atë pjesë të maksigrafit të arrij në një çmim real. E jo ndoshta të jetë krejt diferenca e paraqitur e atij maksigrafi që paraqitet. Ne në të kaluarën kështu e kemi zgjedhur me këtë formë. Por, ndoshta me ligje sot, nuk e kam lexuar saktësisht, por besoj që duhet të jetë vetëm diferenca. Por mund t'ju them se që sa herë ndalet rryma, dhe lëshohet rryma, gjithnjë ka me pagu dikush me ndëshkim, sepse në atë moment gjithë motorët kyçen në mënyrë të përnjëhershme dhe jep një atak maksigrafit. Maksigrafi paraqet disa maksimume joreale për biznesin kosovar. Dhe aty menjëherë ajo ndëshkohet me çmimin e faturës, që nuk është me fajin e menaxhimit të kualitetshëm të pajisjeve të elektromotorëve. Prandaj, duhet ndoshta të studiohet pak më mirë çështja e diferencës, e ndoshta me e lënë si formë, për arsye se ajo s'duhet me qenë pjesë ndëshkuese, por pjesë stimuluese, që industria me e përdor energjinë elektrike me kujdes. Prandaj, ky është qëllimi i maksigrafit.

## 8. Shqyrtimi i Tarifave Progressive të Energjisë Elektrike nga ZRRE-ja (AKB)

**Ministrja Bajrami:** Edhe pikën e radhës e kemi pikërisht me çështjen e energjisë, që është e parashtruar nga Aleanca Kosovare e Bizneseve. Besoj që për çështje të energjisë duhet të diskutojmë sa më shpejtë, në mënyrë që ne të gjejmë zgjidhje për bizneset tona. Nuk është gjithmonë vetëm mungesa e energjisë elektrike, për të cilën Qeveria dhe MZHE-ja po punojnë që të adresohet, por janë edhe këto çështje tjera. Mbetemi te shqyrtimi i tarifave progressive të energjisë elektrike. Por, para se t'i kaloj fjalën z. Shahini, ne parimisht po pajtohemi që për çështje të ZRRE-së, shqyrtimit të tarifave, të maksigrafit dhe çështjeve të tjera, në koordinim me ZKM-në, MTI-ja do e thërras një takim, para takimit të radhës të KKZHE-së, në mënyrë që ne t'i



shqyrtojmë këto çështje. Në fakt ne do t'i adresojmë me shkrim te ZRRE-ja dhe më pas do të takohemi, për të dëgjuar propozimet e tyre konkrete, për zgjidhjen e çështjeve të cilat po ngriten në këtë takim, por edhe për çështjet tjera të cilat i kemi ngritur nga ZKM-ja.

**Agim Shahini (AKB):** Me datë 23 shtator 2016 AKB ka adresuar këtë kërkesë tek ju, dhe tek ministrat tjerë. Për çështjet që u diskutuan pothuajse edhe nga disa parafolës tonë, dhe kjo është mirë sepse e pasuron këtë kërkesë tonën. Kjo është mirë që të gjithë të fokusohemi në zgjedhjen e këtij problemi dhe më pëlqej fjala jote kur i'u the përfaqësuesve të ZRRE-së, se gjithmonë po thoni e kemi diskutuar, do ta diskutojmë por veprime konkrete ende nuk janë ndërmarrë. Unë mendoj se është momenti që duhet të merret. AKB pothuajse qe një dekadë e gjysmë, vazhdimisht ka shprehur shqetësimet edhe sa i përket politikave fiskale, por edhe të energjisë elektrike, si një nga problemet kyçe, e që në top-listën e problemeve për të zhvilluar një biznes në Kosovë energjia e ka vendin e katërt. Prandaj ne kemi menduar se edhe tarifat progresive, edhe maksigrafi, por edhe parapagimi për energji elektrike është si rrjedhojë e ZRRE-së, e cila mendoj se kjo është kundër parimeve të ekonomisë së tregut dhe doktrinës të gjithë ekonomisë të Kosovës për të qenë një treg sa më liberal. Këto të gjitha ndikojnë drejtëpërdrejtë në vështirësitë për të bërë biznes në Kosovë. Prandaj aplikimi i tarifave progresive për AKB, e që i kemi marrë ankesat e vazhdueshme është një logjikë e çuditshme. Në kuptimin, se sa më shumë të harxhosh kilovat energji çmimi është më i lartë, dhe kjo është e çuditshme. Sa i përket maksigrafit u shterren disa pika që u diskutuan, nuk po dua të ndalem sepse ka qenë një nga pikat që ne e kemi kërkuar, por edhe është tepër e panevojshme. Prandaj është mirë që të gjithë po pajtohemi për këtë pikë, por gjërat nuk po lëvizin dhe lind pyetja se ZRRE-ja kujt duhet t'i jep përgjegjësi. Qeveria e Kosovës a duhet të ndërmarrë hapa konkret për të reformuar apo për të zgjedh këtë problem, sepse po që se edhe ky problem do të ishte i zgjidhur, me siguri Kosova do të renditej më mirë sa i përket të bërit biznes. Programimi apo parapagimi i energjisë elektrike; kjo mendoj se është një problem në veti. Prandaj këto tri kërkesa janë në kundërshtim me ligjin ku duhet t'i plotësojmë disa standarde. Aplikimi i tarifës nga 200 Kilovat deri në 600 që rritet vazhdimisht, dhe mbi 600 pothuajse bizneset të gjitha janë të prekura. Kjo është tepër e lartë. Prandaj, mendoj se këtu duhet të hiqet logjika që sa më shumë më shpenzu aq më shumë duhet paguar. Le të paguhet më shumë, por jo në kuptimin e dënimit pse është një tarifë tjetër. Këtu e kemi edhe zv. Kryeministrin dhe ky e din shumë mirë se kur dikush harxhon diçka më shumë, blen diçka më shumë, ajo është çmim më i lirë, kurse tek energjia është ndryshe. Dhe e gjithë kjo, nuk po dua shumë të ndalemi, sepse shkresa ekziston në të gjitha institucionet shtetërore të Kosovës që nga ajo datë. Kërkoj nga MZHE-ja, MTI-ja që edhe të merr për bazë edhe aplikimin e tarifave nëpër vendet regjionale, sepse u përmend Maqedonia; edhe Maqedonia po i konkurren tepër tregut të Kosovës, me të gjitha ofrimet dhe shërbimet për të bërë biznes, edhe në këtë rast edhe për energji, dhe ajo çka duhet të diskutojmë znj. Ministre, që në momentin kur një investitor investon në trafo, ajo duhet që menjëherë t'i qitet në pronësi ZRRE-së apo KEDS-it, si pronësi e tyre, kurse investimet janë private. Kështu nuk ka askund në botë. Askund këtë nuk e pranon ekonomia e tregut, që t'i falet aseti një korporate, sepse kjo është ndoshta një diskriminim më i madh që i bëhet vet bizneseve.

**Ministrja Bajrami:** Edhe për këtë pikë dhe për të gjitha çështjet që u ngritën, mbetet që ne t'i drejtohem me shkrim ZRRE-së dhe të caktojmë në koordinim me ZKM-në dhe të gjithë akterët që janë këtu prezent, do të ftohen pikërisht për këto çështje: maksigrafi, tarifat progresive, tarifat verë-dimër, çështja e bartjes së pronësisë së investimeve nga ana e ndërmarrjeve private të KEDS-it dhe të shohim. Në fakt në takim duhet të jenë të ftuar edhe përfaqësuesit e KEDS-it, edhe besoj se edhe sot janë këtu prezent, por edhe përfaqësues të ZRRE-së. Atëherë po besoj se nuk mundemi

sot që të gjejmë zgjidhje për këto çështje, por mbetet që në fillim të vitit 2017, të caktojmë një takim dhe të diskutojmë për këto çështje.

## 9. Përbushja e detyrave nga mbledhja e gjashtë (Sekretariati i KKZHE-së)

**Ministrja Bajrami:** Sekretariati i KKZHE-së e ka shpërndarë listën e detyrave nga mbledhja e kaluar. Kërkoj nga Lulzim Krasniqi, këshilltar politik dhe shef i kabinetit tim të prezantoj statusin e përbushjes së obligimeve institucionale.

**Lulzim Krasniqi (MTI):** Siç e dini, Sekretariati i KKZHE-së e ka shpërndarë listën e detyrave të dala nga ky Këshill për institucionet e ndryshme pjesëmarrëse dhe pranon zakonisht freskimin e statusit të detyrave. Nga disa institucione kemi pranuar freskimin e detyrave, nga disa jo, por shpresojmë se do ta marrim edhe pas këtij takimi. Një nga detyrat e përcaktuara edhe më herët ka qenë projektligji për inspektimet. Kemi raportuar edhe në takimin e fundit se në bashkëpunim me ZKM-në, MTI është duke bashkëpunuar në krijimin e dokumenteve të nevojshme për të shkuar me reformën e përgjithshme të inspektimeve, dhe besojmë se gjatë vitit të ardhshëm, do të filloj procesi i reformimit të përgjithshëm të sistemit të inspektimeve, ku përfshihet aspekti i legjislacionit si dhe aspekti i reformimit të strukturës organizative të sistemit inspektiv në Kosovë. Pika tjetër, ka të bëjë me Ligjin me Dhënien në Shfytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme; edhe rreth kësaj në takimin e fundit jemi informuar se MAPL-ja është duke punuar në hartimin e koncept-dokumentit dhe në draftimin e projektligjit. Pika numër tre ka pasur të bëjë me Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave, ku MF ka deklaruar se në kuadër të grupit punues për hartimin e Ligjit për Bashkimin e ATK-së dhe Doganës do të adresohet kjo çështje. Lidhur me rekomandimin e dalur nga KKZHE për adresimin e çështjes së avullimit, apo humbjes së peshës së produkteve të caktuara, e tha edhe ministri i financave më herët, MF ka formuar GP dhe kjo çështje do të gjej zgjidhje përmes pakos së re fiskale. KKZHE-ja ka kërkuar nga GP-se dhe ministrinë për kompletimin e task forces së të bërit biznes dhe kjo detyrë është kryer; GP-se janë formuar dhe kanë filluar punën për ciklin e ri të reformave. Pika tjetër e trajtuar në mbledhjen e fundit ku Këshilli ka kërkuar nga Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) që të mundësohet aplikimi i sistemit 'online' të pagesave për sigurimin kufitar për mërgimtarët – nuk kemi pranuar ndonjë raportim në lidhje me zhvillimet rreth kësaj teme. Ne i kemi ftuar të marrin pjesë në këtë takim dhe besoj që kanë ndonjë koment në lidhje me këtë zhvillim. Pika tjetër poashtu lidhet me BKS-në - lidhur me draftimin e një raporti për KKZHE-në në të cilin ata japin opsionet lidhur me çështjen e anëtarësimit të Kosovës në Kartonin e Gjelbër. As për këtë nuk kemi marrë ndonjë raportim. Lidhur me çështjen e prodhuesve kosovarë të materialit ndërtimorë: në mbledhjen e fundit Këshilli vendosi që të punohet në krijimin e një pako fiskale të veçantë për këtë sektor. Informacionet që i kemi marrë nga MF-ja janë se MF e ka bërë plotësim/ndryshimin e UA për lirimet doganore ku janë përfshirë: lirimi nga detyrimi doganor për petrokoksin, vajrat si lëndë djegëse dhe vajrat lubrifikante. UA ka hyrë në fuqi dhe po zbatohet dhe kjo detyrë mund të konsiderohet e kompletuar. Detyra tjetër lidhet me trajtimin e investitorëve nga Agjencitë e Pavarura. KKZHE-ja në mbledhjen e kaluar ka vendosur që MZHE-ja të marrë rolin e koordinatorit, dhe në mbledhjen e radhës të vij me propozimin se si të zgjidhet çështja e "one stop shop"-ve, me qëllim të ofrimit sa më efikas të shërbimeve për bizneset. Nuk kemi marrë ndonjë koment nga MZHE-ja në lidhje me këtë zhvillim. Besojmë se meqë e kemi ministrin këtu do të na informoj më hollësisht dhe saktësisht në lidhje me këtë aspekt. Pika tjetër bën fjalë për vendimin e Këshillit në mbledhjen e fundit, i cili ka vendosur që të formohet GP për trajtimin e iniciativës

për vendosjen e banderolave. Edhe për këtë na foli më herët ministri i financave, i cili ka formuar grupin punues i cili e ka analizuar këtë iniciativë, dhe kjo poashtu do të adresohet përmes pakos së re fiskale. Besoj se për shumë nga pikat të cilat ne nuk kemi pranuar freskim të statusit të tyre do të na flasin përfaqësuesit e institucioneve përgjegjëse.

**Ministrja Bajrami:** Unë po shoh se disa nga ministrat i kemi prezent, po ju jap fjalën në qoftë se dëshirojnë ta marrin. Përndryshe, tek BKS-ja unë kërkoj miratimin e juaj që në emër të KKZHE-së ne të ju dërgojmë letër që ata të përgjigjen me një afat të caktuar, në fakt deri në mbledhjen e radhës. Si duket askush nga BKS nuk është prezent në takimin e sotëm, derisa nuk i kanë kryer detyrat edhe punët, atëherë ne si Sekretariat do marrim në përgjegjësi që t'iu shkruajmë një letër, të ju japim një afat të caktuar që ata të vijnë me përgjegje dhe detyrat të cilat i ka ngarkuar Këshilli. Këto nuk janë të formës dëshirore, janë shumë obligative sepse ky Këshill udhëhiqet nga Kryeministri i Republikës së Kosovës, dhe ne ndoshta në një të ardhme të afërt duhet të flasim edhe për masat të cilat duhet të ndërmerren për ata të cilët nuk pranojnë që të kryejnë detyrat dhe obligimet që dalin nga Këshilli. Ministri Murati dëshiron që të flasë në lidhje me BKS-në dhe kërkesat që ky i ka parashtruar BKS-së.

**Valon Murati (MeD):** Shumë shqetësues fakti që ka muaj që ne mbledhjen e fundit e kemi mbajt dikur në qershor dhe BKS as nuk ka dërgu ndonjë raport për obligimet që i ka marrë, Nëse ju e mbani në mend të gjithë, nga BKS-ja kemi pasë një premtim publik se shumë shpejtë do të rregullohet; mandej ka qenë edhe 1 korriku si datë e përcaktuar se do të rregullohet çështja e pagesave 'online' të tarifave. Ky është një problem të cilin e kemi shtruar vazhdimisht me ta, sepse bashkëatdhetarët kanë kërkuar që së paku t'u lehtësohet çështja e pritjes në kufi. Ju e dini tash do të vjen periudha e pushimeve të fund vitit, në kufijtë tonë fatkeqësisht ende nuk kemi krijuar resurse që t'i zgjerojmë, është pjesë e projekteve të viteve të ardhshme, projekti i zgjerimit të menaxhimit të integruar të kufijve, edhe në Merdare, edhe te Dheu i Bardhë dhe do të kemi sigurisht pritje të gjata. Një prej shkaktarëve do të jetë pagesa e tarifave të sigurimit kufitar nëpër kufij, dhe ne kemi kërkuar që së paku deri sa nuk zgjidhet çështja e heqjes tërësisht të tarifës, përmes një zgjidhje të pranueshme që kjo të bëhet online, kjo nuk ka ndodhur. Unë e di që ka pasë ndryshime në udhëheqjen e BKS, por kjo nuk është arsye që ne mos të kemi një përgjigje dhe një reagim në këtë drejtim. Gjithashtu, është për të ardhur keq që ne nuk e kemi atë plan të punës për të cilin jemi marrë vesh. E këtu e kemi biseduar para sa muajsh, se faji ose fajtori po mbetet jetim se kush është përgjegjës për çështjen e zgjidhjes së anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Byrove, atë që ne e quajmë në jetën e përditshme "kartoni i gjelbërt." Duke qenë që është proces pak më i komplikuar, kemi kërkuar që BKS-ja të vjen me një plan të veprimit, se çfarë hapa duhet të marrin të gjitha institucionet, duke përfshirë ata, duke përfshirë qeverinë, duke përfshirë gjithë mekanizmat e tjerë, që Kosova - së paku nëse jo tërësisht - ta gjej një modus të zgjidhjes së problemit të tarifës të sigurimit kufitar, për të cilin bashkëatdhetarët do të bëjnë shumë problem, sepse gjithë përfaqësuesit e ekonomisë e dinë që ajo i godet jo vetëm bashkëatdhetarët, por i godet edhe gjithë ata që eksportojnë dhe importojnë në Kosovë. Kështu që t'u a dërgojmë një letër të hapur, ku duhet ta bëjmë këtë çështje të madhe, sepse nuk mund të vazhdojmë me praktikën e mospërgjegjësisë ndër-institucionale. Mua më duket pak propagandistike, por disi duhet të krijojmë një momentum presioni, ndaj këtyre mekanizmave, në mënyrë që ato të vihen në lëvizje. Sepse, vërtetë është papërgjegjësi jo vetëm që nuk kanë pru koment, jo vetëm që nuk i kanë realizu ato premtime publike që i kanë bërë, por nuk kanë ardhur sot as në takim.

**Ministrja Bajrami:** Në fakt ne si Sekretariat dhe koordinues të KKZHE-së kemi menduar që ata

do të vijnë në takim dhe të gjitha këto do t'ua themi. Ndërkohë që unë u konsultova më zv. Kryeministrin, ne u pajtuam që së bashku me ju, nëqoftë se jeni të disponueshëm gjatë kësaj jave t'i ftojme BKS-në në një takim të cilët do i marrin në përgjegjësi dhe do të kërkojmë që ata t'i kryejnë detyrat e tyre konform afateve të reja që ne i vendosim.

**Ministri Stavileci (MZHE):** Në kuadër të këtyre veprimeve që janë paraparë shumë konkrete, ndoshta e para, po flas për procesin duke i lidhur me atë që është diskutuar për BKS-në, edhe pse ne nuk e kemi përgjegjësi të drejtëpërdrejtë dhe nuk jemi bartës institucional për realizimin e tij. Por sidoqë të jetë mendoj që është mirë që nëse hera e kaluar, ose edhe kësaj radhe, sepse po më duket se statusi i të gjithave me përjashtim të formimit të grupit - në proces, dhe po i bie që të gjitha janë duke u zhvilluar në një mënyrë, dhe nuk po i dijmë problemet dhe është mirë të dihen problemet dhe pastaj të adresohen në mënyrë shumë të saktë. Sepse po shihet edhe nga diskutimet se nuk është e njëjtë si pika e tetë, me pikat e tjera. Për sa i takon pikës së dhjetë, e para në këtë Këshill është bërë një prezantim për "one stop shop"-et për burimet e ripërtrishme të energjisë. Ne e kemi përgatitur udhëzimin administrativ së bashku me partnerët ndërkombëtarë dhe tash e kemi të gatshëm. Këtë javë do ta procedojmë për konsultim publik, dhe pra shumë shpejtë do ta nënshkruajmë. Por edhe këtu duhet ditur dy gjëra: njëra që vlen konkretisht për fushën dhe gjendjen aktuale, dhe e dyta që duhet të jetë përsëri një diskutim strategjik se si do të veprojmë në të ardhmen, e që lidhet pastaj me atë që e kemi në këtë pjesën ku thuhet se si të zgjidhet çështja e "one stop shop-ve" me qëllim të ofrimit efikas të shërbimeve. E para që ne edhe këtë "one stop-shop" e kemi bërë me përgjegjësi të natyrës informative dhe bashkërenduese. Dhe, nuk mund ta bëjmë me përgjegjësi ekzekutive, që i bie që përsëri në proces kemi problem, por të paktën aspektin informativ dhe kordinues do ta kemi në nivel më të duhur. E dyta, pra ajo që e thashë si diskutim strategjik për të ardhmen. Ne e kemi menduar që ky model i "one stop-shop"-it për burimet e ripërtrishme të energjisë, që pastaj do të aplikohet edhe për sektorin minerar, të vlej edhe për fushat e tjera. Mirëpo, ne duhet që këtu, pastaj ne, si MTI-ja, atëherë është bërë si është bërë, por nganjëherë mendoj detyrat dhe misionin nuk i kemi mirë të shpërndara, sepse nëse flasim për të gjithë sektorët dhe për të gjitha industritë, atëherë ne duhet ta mendojmë një ligj për "one stop-shop"et, por këtu duhet ta kemi parasysh që me këtë ligj do t'i preknim të gjitha kompetencat e autoriteteve rregullative. Pra është më shumë sesa vullnet politik. Është një revolucion të cilin ne si ministri dhe unë si ministër jemi të gatshëm ta bëjmë gjithmonë në dobi të sektorit privat, por duke e pasur parasysh edhe balancën në mes atyre që i bëjnë politikat dhe autoriteteve rregullative. Është mirë që të ekzistojë një kufi ndarës në mes të këtyre, por mos të na përseriten situatat. Pra ne gjatë gjithë vitit të bombardohemi nga kërkesat e bizneseve e pastaj i kemi të tjerët që e rregullojnë tregun. Ne nuk e rregullojmë tregun dhe unë jam i vetëdijshëm që as nuk duhet ta rregullojmë, sepse dihet se duhet të funksionoj derregullimi në plotësi, por tash edhe ta gjejmë një balancë më të mirë në mes të politikbërjes dhe rregullimit të tregut, gjithmonë në dobi të sektorit privat. P.sh. sot, për informatën tuaj, e kemi përsëritur edhe kur është bërë prezantim këtu për burimet e ripërtrishme. Ne kemi shumë institucione që marrin pjesë në hapat e ndryshëm deri te qëllimi final që është lejimi, pra i autorizimit final që do bëhet nga ZRRE-ja. Unë nuk ka javë që nuk kam kërkesa nga investitorët për të ardhë dhe për të investuar në vendin tonë, e në anën tjetër gjithçka që lidhet me procesin e pajisjes së tyre me leje e licenca, varet prej institucioneve tjera dhe në këtë rast do të thosha edhe ZRRE-ja si një terminal pastaj i pajisjes së tyre me to. Ne po e nisim me këtë UA por mendoj që ka nevojë edhe me bizneset, por edhe ne mes veti për një konsult më të plotë, më të thellë edhe më shterruese, në mënyrë që në të ardhmen ta ndryshojmë njëherë e përgjithmonë, sepse nuk mjafton tash, sepse bëhet edhe më keq, një lloj

dispariteti në mes fushës së BRE-ve dhe sektorit mineral, e sektorët tjerë të mos kenë “one stop-shop”-e.

**Ministrja Bajrami:** Në fakt, disa ministri i kanë “one stop-shop”-et e veta. Ne si ministri i kemi për shërbimet të cilat i ofrojmë. Është e vërtetë ajo që ne gjatë gjithë vitit bombardohemi nga kërkesat e ndryshme të bizneseve, mirëpo në KKZHE sjellim vetëm ato që kanë një arsyeshmëri ekonomike dhe unë po besoj që çështja e energjisë, tarifave, maksigrafi, Ligji i Punës, lejet dhe licencat, politikat fiskale janë pikërisht në mandatin e institucioneve që ne jemi përgjegjës të ofrojmë kushte më të favorshme, në mënyrë që mandej operatorët e suksesshëm në tregun ekonomik, të mund të ju bëjnë ballë edhe konkurrencës, por edhe bëjnë biznesin e tyre pa u varur nga institucionet. Domethënë kërkesat për subvencione, për grante të biznesit të cilat i kemi 24 orë në MTI, ne nuk i sjellim sepse po mendojmë që biznesi duhet të punojë dhe të zhvillohet me kapitalin e vet dhe jo duke e mbajtur me ndihma buxhetore, sepse buxheti mbushet nga taksat dhe nuk ka justifikim që ne të penalizojmë bizneset që paguajnë taksat dhe t’u japim atyre që dëshirojnë në çfarëdo forme që të provojnë të bëjnë biznes. A ka dikush diçka tjetër lidhur me listën e detyrave që kanë dalë nga mbledhjet e kaluara? Ne sa herë që e dërgojmë agjendën dhe ftesën për takimin e ardhshëm, për secilin takim, mirëpo edhe tash menjëherë pas takimit për çfarëdo që jemi dakorduar në Këshill, ne e dërgojmë listën e detyrave me institucionet përgjegjëse. Nëse keni komente, nëse mendoni që përgjegjësia nuk është e juaja, siç jemi dakorduar, atëherë është mirë që këto komente t’i dërgohen sekretariatit të KKZHE-së. Ndodh që shpesh një detyrë është në kompetencë të disa institucioneve. Unë po pajtohem që ne i kemi institucionet e pavarura, mirëpo ato janë të pavarura në momentin që punojnë mirë. Në momentin kur ato nuk punojnë dhe nuk i përgjigjen as Kryeministrit të Republikës së Kosovës, ne si KKZHE duhet të marrim masa. Nuk duhet ta ketë komoditetin dikush, ashtu siç e ka deri më tani BKS-ja, që të mos merr mundin as të mos vij në këtë diskutim.

**Visar Hapciu (OEA):** Meqenëse është njëra prej pikave e cila u raportua, lidhur me bordin e pavarur për rishqyrtime. Ne së fundmi e kemi pasë një tryezë dhe është kërkesë e gjithmbarshme e bizneseve për me u funksionalizuar një trup i tillë. Javën e kaluar ne kemi marrë informacione që në kuadër të Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Financa është angazhuar një ekspert me i shqyrtu modalitetet, se si mundet me u funksionalizuar një forum i tillë. Edhe ndoshta duhet me u pasqyruar në raport.

## 10. Raportimi për punën e GP-se të KKZHE-së (Kryesuesit e GP-se)

**Ministrja Bajrami:** Ministri i Financave nuk pati diçka të shtoj. Ai tha që janë në proces, d.m.th. janë formuar GP dhe kjo çështje do të zgjidhet konform kërkesave të biznesit. Shumica e GP-se, përveç MF nuk kanë raportuar në ndonjë raport për aktivitetin e tyre gjatë kësaj periudhe. Nëse ndonjëri nga kryesuesit e GP ka diçka për të raportuar, e keni mundësinë tani. Unë sa i përket GP për çështje tregtare dhe eliminim të barrierave tregtare po ju njoftoj që ne si ministri kemi trajtuar të gjitha barrierat, ato të cilat janë raportuar në MTI dhe zyrtarisht. Së fundmi kemi marrë një kërkesë nga M & Sillosi, e cila ka shkuar te Komisioni Parlamentar. Në fakt, kurrë asnjëherë më herët nuk kemi qenë të informuar si ministri, është fjala për barrierat tregtare, në bazë të një rregulloreje që Shqipëria i vë miellit të prodhuar në Kosovë. Është fjala për përqindjen e proteinave. Ne e kemi ngritur në nivel bilateral me ministren znj. Milva Ekonomi, dhe ajo na ka

premtuar që kjo çështje do të zgjidhet së shpejti. Nuk kemi barriera të tjera të cilat i kemi të raportuara. Ndërmarrjet kosovare, dhe unë këtu lus asociacionet e bizneseve që komunikojnë me anëtarësinë e tyre, mund të kenë barriera, mirëpo nëse nuk i kemi të raportuara apo të dokumentuara ato nuk mund t'i adresojmë. Andaj inkurajoni anëtarësinë e juaj që në momentin kur kanë barriera të ndryshme tregtare, ata të vijnë në MTI dhe të sjellin dokumentet në mënyrë që ne mandej t'i ngrisin ato qoftë në komitete të CEFTA-s dhe në nivel bilateral. A ka dikush tjetër? Ministri Murati, grupi për lehtësim dhe tërheqje të investimeve nga diaspora, nëse keni diçka për të raportuar?

**Ministri Murati (MeD):** Ne po e vazhdojmë punën në baza ditore, në bashkëpunim me bizneset. Nuk kam diçka ndonjë çështje të posaçme për të raportuar.

**Ministrja Bajrami:** Në fakt GP-se kanë funksionuar shumë mirë, ka shumë çështje që vijnë nga asociacionet e biznesit dhe ne po i adresojmë përmes GP-se. Kjo edhe është edhe arsyeja përse një kohë të gjatë nuk kemi mbajtur takim të KKZHE-së, sepse një sërë çështjesh të ngritura nga asociacionet janë adresuar përmes GP-se pa pasur nevojë që ato të sillen në KKZHE.

### 11. Mbyllja e takimit, caktimi i datës së mbledhjes së ardhshme të KKZHE-së

**Ministrja Bajrami:** Kërkoj miratimin e juaj në parim që në mes të muajit mars të takohemi, mirëpo mbetet obligim i yni që të takimin me ZRRE-në dhe KEDS-in ta organizojmë para kësaj date. Për datën e saktë nuk po pajtohemi, le të mbetet në mesin e muajit mars që të jetë mbledhja e radhës dhe gjithashtu unë ftoj të gjithë anëtarët të KKZHE-së që të bëjnë propozimet e tyre për temat e rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme më së voni deri me 28 shkurt 2017. Gjithashtu, kërkoj mirëkuptimin e juaj për plotësimin e tabelës sa ju përket detyrave të cilat janë në vijim e sipër. Domethënë kur proceset dhe këto çështje të cilat i kemi në proces e sipër, shpresoj se deri në mbledhjen e ardhshme t'i kemi të përfunduara. Janë disa çështje si përmirësimi i ambientit të biznesit; është diçka e cila asnjëherë nuk përfundon, gjithmonë ka diçka të re që duhet të bëjmë në këtë fushë. Mirëpo, në shumicën e fushave janë çështje të cilat mund të rregullohen qoftë me vendime të ministrave, qoftë me akte të tjera legjislative dhe mendoj që tre muaj janë të mjaftueshëm që ato të përfundojnë duke marrë parasysh që ka kohë që i kemi filluar. Atëherë nëse dikush nuk ka diçka tjetër, unë ju falënderoj të gjithëve për kontributin. Urime festat e fundvitit dhe mirë u pafshim në mbledhjen e ardhshme të KKZHE-së. *KKZHE përmbyll takimin e shtatë.*